

VENDIM
NR. 181, datë 26.2.2020

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2020 PËR
DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE, PËR PËRBALLIMIN E
SHPENZIMEVE TË ORGANIZIMIT TË SAMITIT DIGJITAL TË BALLKANIT
PERËNDIMOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936/2016, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shërbime qeveritare”, i shtohet fondi prej 44 000 000 (dyzet e katër milionë) lekësh për përballimin e shpenzimeve të organizimit të “Samitit Digjital të Ballkanit Perëndimor”, që do të organizohet në Tiranë, në datat 2 dhe 3 prill 2020.

2. Efekti financiar prej 44 000 000 (dyzet e katër milionë) lekësh të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2020.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për koordinimin e organizimit të këtij samiti dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe